



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr.185/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.N. nga Gj., për shkak të veprës penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.20/2017 të datës 13.03.2017, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datën **10.09.2018,** në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F.N.,** i biri i L. dhe i ëmës Sh., e gjinisë L., data e lindjes... në Gj., ne rrugën “B.C.” nr. ..., ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i R.së K..i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar atë i 3 fëmijëve, - pensioner , me nr. personal

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse: Me datën 01.01.2017 rreth orës 11.30 në rrugën “N.T.” në Gj., saktësisht në kafetërinë në Q.T. C.M.në Gj., me qëllim të përvetësimit të sendit të huaj në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim fitimi merr portofolin me para prej 520 euro pronë e të dëmtuarit V. H. nga P., në atë mënyrë që për derisa të njëjtit i kishte rënë portofoli afër ulëses në të cilën kishte qenë duke pirë kafe, i pandehuri F. me të vërejtur afrohet tek ulësja, e merr portofolin, ku parat në vlerë prej 520 euro i merr nga aty, ndërsa portofolin me dokumente e hudhë në shportën e mbeturinave në afërsi QT “V.F. me çka të dëmtuarit V. H. i shkakton dëm material në vlerë prej 520 euro.

- me çka ka kryer veprën penale, të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46,50,51,73, dhe nenit 325 par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës.

G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti,** nuk kryen

ndonjë vepër tjetër penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **100 (Njëqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohet I akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **30 Euro**, e krejt këtë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari V.Ha. nga Pr., Rr.”J.P.” nr...., kompensimin e dëmit mund ta realizon në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.20/2017 të datës 13.03.2017, kundër të akuzuarit F.N. nga Gj., për shkak të veprës penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës, për shkak të veprës penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës, dhe ka propozuar që të akuzuarin të shpallë fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Gjykata me dt.12.03.2018 ka lëshuar urdhër arrest kundër të akuzuarit F.N. i akuzuar që ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 prg 1 të KPRK-ës, pasi që i akuzuari F. N., nuk ka marr pjesë në seancën e treguar me dt. 12.03.2018, Stacioni Policore ne Gjakove, me referencën me nr., te dt. 09.03.2018, jemi njoftuar se i njëjti ndodhet jashtë shtetit te K. ne Gj..

Me dt. 10.09.2018 i akuzuari F.N. sillet nga Stacioni policor në Gj. , sipas urdhëresës tonë mbi shpalljen e urdhërarrestit, prandaj po të njëjtën ditë është mbajtur shqyrtimi fillestar kundër të akuzuarit F.N. i akuzuar që ka kryer veprën penale vjedhje, nga neni 325 prg 1 të KPRK-ës.

I akuzuari F. N. gjatë shqyrtimit fillestar lidhur me fajësinë deklaroi, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar ne dispozitiv te aktakuzës shtonë: se ne momentin kur kam gjetur kuletën ne Qendrën tregtare C.M., është e vërtete se te njëjtën e kam marrë dhe kam vërejtur se ne portofol kanë qenë 520€, nuk e kam lajmëruar ne qendrën tregtare, nuk kam ditur se jam duke kryer një vepër penale, për te cilën tani pendohem dhe premtoi para Gjykatës se te njëjtën nuk do te përsërisë, shton se jam ne moshe te shtyer jam babai i tre fëmijëve, si dhe te hollat qe i kam gjetur ne shume prej 520€, te nesërmen i kam kthyer ne Polici, për here te parë paraqitem ne Gjykatë për një vepër te kryer penale por premtoi se do te jete edhe hera e fundit. Andaj i propozoi Gjykatës që ti merr parasysh këto rrethana, me rastin e shqiptimit te llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari F.N.; Me datën 01.01.2017 rreth orës 11.30 në rrugën “N.T.” në Gjakovë, saktësisht në kafetërinë në Qendrën Tregtare C.M.në Gjakovë, me qëllim të përvetësimit të sendit të huaj në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim fitimi merr portofolin me para prej 520 euro pronë e të dëmtuarit V.H.nga P., në atë mënyrë që për derisa të njëjtit i kishte rënë portofoli afër ulëses në të cilën kishte qenë duke pirë kafe, i pandehuri F. me të vërejtur afrohet tek ulësja, e merr portofolin, ku parat në vlerë prej 520 euro i merr nga aty, ndërsa portofolin me dokumente e hudhë në shportën e mbeturinave në afërsi QT “V.F.”, me çka të dëmtuarit V.H.. i shkakton dëm material në vlerë prej 520 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është baba i tre fëmijëve, në moshë të shtyrë, është pensioner, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, gjendjen e tij ekonomike, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **100 (Njëqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPK-se.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -

P.nr.185/17 me datën 10.09.2018

**Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.